

COHESION IN JOKIES KOHEZIONI NË BARSOLETA

Jehona KRASNIQI-MORINA¹

¹ *Department of Language, Faculty of Philology, University of Prishtina „Hasan Prishtina“*

^{*} *Corresponding author e-mail: jonakrasniqi@yahoo.com*

Abstract

Cohesion in jokes is the topic we have selected in this paper. Aiming to show that cohesion includes the special linguistic elements of textuality, the interrelationship of units in jokes texts will be presented. The subject in the treatment is important because there are few studies in the linguistics of the text in Kosovo, with which this object of study is also related. Even the object of this paper, in the framework of the theories of the text, is very little treated. This has conditioned the selection of linguistic tools, which will be treated in this paper, some of which are not fully treated either in grammars or dictionaries of the Albanian language. For a more complete treatment of cohesion, we will rely on the study of Bardh Rugova (2009), which refers to the most important authors of text linguistics, who have dealt with the treatment of cohesion, such as Halliday & Hasan, VanDijk, De Beaugrande & Dressler .

Keywords: *lexical cohesion, grammatical cohesion, linguistic tools, textuality, semantic relations.*

Abstrakt

Kohezioni në barsoletave është tema që kemi përzgjedhur në këtë punim. Duke synuar të tregojmë se kohezioni përfshin elementet e veçanta gjuhësore të tekstualitetit, do të paraqitet ndërlidhja e njësive në tekste të barsoletave. Tema në trajtim është me rëndësi për shkak se janë të pakta në Kosovë, studimet në gjuhësinë e tekstit, me të cilën edhe ndërlidhet ky objekt studimi. Edhe vetë objekti i këtij punimi, në kuadrin e teorisë së tekstit është shumë pak i trajtuar. Kjo edhe ka kushtëzuar përzgjedhjen e mjeteve gjuhësore, që do të trajtohen në këtë punim, një pjesë e të cilave nuk janë të trajtuara plotësisht as në gramatikat e as në fjalorët e gjuhës shqipe. Për një trajtim më të plotë të kohezionit do të mbështetemi në studimin e Bardh Rugovës (2009) i cili i referohet autorëve më të rëndësishëm të gjuhësisë së tekstit, që janë marrë me trajtimin e kohezionit si Halliday & Hasan, VanDijk, De Beaugrande & Dressler.

Fjalë kyçe: *kohezion leksikor, kohezion gramatikor, mjete gjuhësore, tekstualitet, marrëdhënie semantike.*

Hyrja

Ky punim shërben si një hulumtim kërkimor, me anë të së cilit analizojmë mjetet gramatikore e leksikore për lidhjen e mendimeve në kategorinë tekstore, në këtë rast në grupin e barsoletave. Për të mbështetur shfaqjen e kohezionit jemi bazuar në 12 barsoleta. Kemi bërë përpjekje të përfshijmë shembuj nga një spektër i gjerë i kësaj kategorie. Shenjat e pikësimit dhe leksikun në barsoletat e marra, i kemi lënë siç janë në tekstet origjinale, disa të nxjerra nga interneti e disa nga gazetat.

Gjatë analizimit të tyre kemi për qëllim të bëjmë matjen e ndodhjes së kohezionit, që paraqet ndërlidhshmëri të njësisive në një tekst barsoleta. Në këtë rast, pritjet kanë të bëjnë me gjetjen e një raporti të ndodhjes së kohezionit gramatikor dhe atij leksikor në këto tekste. Kjo bëhet me qëllimin, që përmes metodës së krahasimit në numër dhe përqindje në shembujt e marrë, të paraqiten rezultate rreth kategorive të kohezionit gramatikor dhe atij leksikor.

Kohezioni

Koncepti i Kohezionit për herë të parë është përdorur më 1976 nga Halliday dhe Hasan-i. Ata e konsideruan kohezionin si një marrëdhënie semantike, por si të gjithë përbërësit e sistemit semantik, që realizohet me anë të sistemit leksiko-gramatikor.

Kohezioni ndodh kur interpretimi i një elementi në tekst varet nga interpretimi i një tjetri (Halliday & Hasan, sipas B. Rugovës, 2009:149). Kohezioni përfshin elementet e veçanta gjuhësore të tekstualitetit. Ai ka të bëjë me mënyrën se si lidhen midis tyre në bazë të rregullave gramatikore të gjuhës njësitë që përbëjnë tekstin. Meqenëse mendimet a gjykimit tona nuk mund t'i shprehim me një fjalë ose thënie të vetme, si në ligjërimin e folur ashtu edhe në atë të shkruar ne prodhojmë thënie (ajo që thuhet për diçka; mendim, pohim, shprehje, fjalë – togje prej dy a tri fjalësh, etj) të lidhura midis tyre. Pra ligjërimi ynë është i lidhur.

De Beaugrande dhe Dressler kohezionin e përcaktojnë *sitë parin nga të shtatë standardet e tekstualitetit* (B. Rugova, 2009:148). Në konceptet e Hallidayt dhe Hasanit (1974, vep. e cituar sipas B. Rugovës, f.149) *tekst konsiderohet çdo pjesë e thënë ose e shkruar, pavarësisht nga gjatësia, që e formon një tërësi të njësuar*. Kohezioni trajtohet si një nga kriteret kryesore për ndërtimin e tekstorësisë. Halliday dhe Hasani (B. Rugova, f.150) veçojnë dy kategori të përgjithshme të kohezionit: kohezioni gramatikor dhe kohezionin leksikor. Kohezioni gramatikor ka të bëjë me të kuptuarit e strukturave gramatikore si strategji për të lidhur mes vete njësi të ndryshme të tekstit.

Në fjali kohezioni realizohet me anë të vendosjes së njësisive në varësi gramatikore të caktuara, kurse në njësi më të mëdha në tekst, veprimi kryesor që duhet të bëhet është që të zbulohet mënyra sesi elementet e përdoruar të ripërdoren dhe modifikohen. *Mënyra se si tiparet gramatikore ngërthehen në fjali, ose në kufij të fjalive konsiderohet kohezion gramatikor* (McLoughlin, 2000:85, vep. e cit. sipas B. Rugovës, f.151). Kohezioni gramatikor realizohet nëpërmjet: referencës, zëvendësimit, elipsës dhe mjeteve lidhëse. Kohezioni leksikor, ka të bëjë me mënyrën se si aspekte të vokabularit i lidhin ose i bëjnë bashkë pjesët e tekstit (po aty). Ky ndahet në dy grupe: rimarrja (përsëritja, sinonimet, hiponimet, metonimia dhe antonimet) dhe kolokimet

1.NË KONCERT

Shkon një burrë në koncertin e muzikës klasike dhe kur kthehet e pyet shoku i tij:

“Dhe si t’u duk koncerti?”

“Uf shumë mirë”

“Mirë e cila ishte pjesa më e mirë?”

“Ajo në fund, kur filluan të shpërndajnë pallto, unë i mora tri!”

Kohezioni gramatikor:Referencë vetore:

Shkon një burrë në koncertin e muzikës klasike dhe kur kthehet e pyet shoku i tij:
“Ajo në fund, kur filluan të shpërndajnë pallto, unë i mora tri!” –referencë vetore

Lidhshmëria:

“Dhe si t’u duk koncerti?” lidhëza shtuese *tipi këpujor-shtesor*.

Kohezioni leksikor: Përsëritje

Shkon një burrë në koncertin e muzikës klasike dhe kur kthehet e pyet shoku i tij: “Dhe si t’u duk koncerti?”

Mirë e cila ishte pjesa më e mirë?

2. FATKEQËSIA

I thotë gruaja burrit:

“Kam lexuar se numri më i madh i fatkeqësive ndodhin në kuzhinë”

“Këtë e di. Aty i shkreti gjithmonë detyrohem t’i ha ato fatkeqësi”

Kohezioni gramatikor:

Referencë : Këtë e di. -Referencë dëftore

Lidhshmëri

Aty i shkreti gjithmonë detyrohem t’i ha ato fatkeqësi- Lidhshmëri tipi kohor

Elipsa

Kam lexuar se numri më i madh i fatkeqësive ndodhin në kuzhinë”– (0)

Kohezioni leksikor :

Antonim:I thotë gruaja burrit:

3. NATALITETI

- A po e sheh mori, çdo vit e më pak foshnje po lindin, thotë njëra.

- Po, për këtë arsye na ka ra mentaliteti!, ia kthen tjetra.

Referenca:

...çdo vit e më pak foshnje po lindin, na ka ra mentaliteti për këtë arsye na ka ra mentaliteti!

Lidhshmëria: tipi kohor

çdo vit e më pak foshnje po lindin

Elipsa:

A po e sheh mori. (0) = ti

Kohezioni leksikor

Kolokim:

çdo vit e më pak foshnje po lindin

4. MOLLËT

Shumë sport dhe pak cigare, e këshillon doktori pacienten. Kështu në qoftë se doni të pini cigare atëherë në moment hani një mollë

- Mirë i thotë pacientja. Por doktor 60 mollë në ditë a nuk janë pak si shumë?

Kohezioni gramatikor

Zëvendësim; Shumë sport dhe pak cigare, e këshillon doktori... Kështu nëse doni të pini cigare...

Lidhshmëri kushtore: Kështu në qoftë se doni të pini cigare atëherë

Kohezion leksikor:

Përsëritje ...e këshillon doktori pacienten. ... Mire i thotë pacientja

..... e këshillon doktori... Por doktor 60 mollë në ditë a nuk janë pak si shumë

Shumë sport dhe pak cigare, e këshillon doktori pacienten. Kështu në qoftë se doni të pini cigare

Mollë - mollë

Antonim: Shumësport dhe pak cigare.

5. NË MËRGIM

Nete, e ke dëgjuar atë tregimin me babain plak?

Shkon babai plak për vizitë në mërgim tek i biri.

Një ditë prej ditësh, ai merr të atin dhe shkojnë në një shitore për ushqim. Gjatë rrugës, djali kthen veturën përballë një banke për të nxjerrë para. E shoqëron edhe i ati...

-O Zot i madh! - thotë plaku. Kaq u bëra, u thinja, u plaka, nuk e dija që këtu në mërgim edhe nga muri rrjedhin paratë!!!

Kohezioni gramatikor : Referenca

Shkon babai plak për vizitë në mërgim tek **i biri**. Një ditë prej ditësh, **ai** merr të atin ...

Elipsa: Kaq **u bëra, u (0) thinja, u plaka...** (0) = unë

Lidhshmëria: mardhënie shtuese

Një ditë prej ditësh, ai merr të atin **dhe** shkojnë në një shitore për ushqim

Kohezioni leksikor:

Përsëritje: ...e ke dëgjuar atë tregimin me **babain** plak? Shkon **babai** plak për vizitë ...

Sinonim: Shkon babai plak për vizitë në mërgim tek **i biri**. Gjatë rrugës, **djali** kthen veturën përballë...

- Shkon **babai** plak për vizitë në mërgim tek i biri. E shoqëron edhe **i ati**.

6. SHQIPTARËT

Disa shqiptar po bisedonin për dallimin në mes të Kosovës dhe Amerikës. Njëri prej tyre tregon se si ne Amerike është shume e lehte te fitohet paraja dhe nëmënyre metaforike thotë 'se paratë gjenden neper rruge...mjafton vetëm te ulesh dhe t'i marrësh ato'... Pas kësaj bisede njeri prej tyre vendos qe te shkoj ne Amerike...dhe shkon.Ditën e parë kur mbërrin atje i sheh në tokë20\$ që i kishin rënë dikujt nga xhepi.

Mendon vet me vete...pasi qe sot është dita e pare dhe jam pak i lodhur nga fluturimi, nuk po punoj. Me mire po pushoj mire, e punën po e filloj nga dita e nesërme....dhe nuk i merr.

Kohezioni gramatikor:

Referencë: *Disa shqiptar* po bisedonin për dallimin në mes të Kosovës dhe **Njeri** prej tyre...

..... Njeri prej tyre vendos qe te shkoj ne Amerikë...Ditën e pare kur mbërrin **atje** i sheh...

Referencë vetore: ... paratë gjenden neper rruge...mjafton vetëm te ulesh dhe t'i marrësh **ato**...

Lidhmëri: me mardhënie shtuese

...në Amerike është shume e lehte të fitohet paraja **dhe** në mënyre metaforike thotë

...punën po e filloj nga dita e nesërme....**dhe** nuk i merr

Elipsa:

Mendon vet me vete (0)= Ai

nuk **po punoj**...(0)= unë

Kohezioni leksikor:

Përsëritje:

...në Amerike është shume e lehte te fitohet **paraja** dhe ne mënyre metaforike thotë 'se **paratë**

...njeri prej tyre vendos që të shkoj nëAmerikë. po bisedonin për dallimin në mes të Kosovës dhe Amerikës

Hiponim: Disa shqiptar po bisedonin për dallimin në mes të Kosovës dhe Amerikës
Metonimi: ...pasi që sot është dita e parë dhe jam pak i lodhur nga fluturimi (aeroplani)
Antonim: Me mire po pushoj mire, e punën po e filloj nesër
Kolokim: Disa shqiptar po bisedonin për dallimin në mes të Kosovës dhe Amerikës.

6. KALI

- "Sikur të mund të lindeshe edhe një here, ç' do të dëshiroje të behësh?" - e pyet njeriu shokun e tij.

- "Paj, ç'të them, ndoshta do të dëshiroja të lindi kali" - ia kthen ky.

- "Jo, jo, nuk bën dy here të lindesh i njëjtte" - ia kthen shoku.

Kohezioni gramatikor:

Referenca

"Paj, ç'të them, ndoshta do të dëshiroja të lindi kali" - ia kthen ky.

Zëvendësim:

- "Paj, ç'të them, ndoshta do të dëshiroja te lindi kali" - ia kthen ky.

- "Jo, jo, nuk bën dy here të lindesh i njëjtte" - ia kthen shoku.

Lidhshmëria me marrëdhënie shtuese:

"Sikur të mund të lindeshe edhe një herë, ç' do të dëshiroje të behësh?" - e pyet njeriu shokun e tij.

Përsëritje:

...ndoshta do të dëshiroja te lindi kali" .. - "Jo, jo, nuk bën dy here të lindesh i njëjtte" - ia kthen shoku.

1. BERBERI

Një berber tu e rruennjë klient e preu në faqe dhe ia vuri një copë pambuk për t'ia ndalur gjakun. Me vone e preu përsëri ne një vend tjetër dhe i vuri përsëri pambuk. Mbasi e përsëriti shume here këtë gjë, klientit nuk ju durua me dhe i tha: Mire këtë ane e mbolle pambuk, po faqen tjetër çka po e mbjell?

Kohezioni gramatikor:

Referencë:

Një berber në rrojtore tu e rruie një klient e preu në faqe dhe ia vuri një copë pambuk për t'ia ndalur gjakun. Mbasi e përsëriti shume here këtë gjë.

Elipsa: Mbasi e përsëriti shumë here këtë gjë. (0)= berberi / ai.

Lidhshmëria këpujor-shtesor :

Berberi tu e rruie një klient e preu në faqe dhe ia vuri një copë pambuk për t'ia ndalur gjaku

Lidhshmëria: Tipi kohor

Me vonë e preu përsëri ne një vend tjetër

Kohezioni leksikor:

Përsëritje

Një berber në rrojtore, tu e rruie një klient e preu në faqe dhe ia vuri një copë pambuk për t'ia ndalur gjakun. Me vone e preu përsëri ne një vend tjetër dhe i vuri përsëri pambuk.

Një berber tu e rruie një klient e preu në faqe dhe ia vuri një copë pambuk për t'ia ndalur gjakun.

Mire këtë ane e mbolle pambuk, po faqen tjetër çka po e mbjell?

Kolokim: Një berber në rrojtore tu e rruen një klient e preu në faqe.

8. FOLJA "ECI"

Mësuesja i tha nxënësit: - Ma zgjedho foljen ec. Ai filloi: Unë ec, ti ec, ai ec. Me shpejt, me shpejt - i tha mësuesja. Unë vrapoj ti vrapon, ai vrapon- ia pritë nxënësi.

Kohezioni gramatikor

Referencë: Mësuesja i tha **nxënësit**: -Ma zgjedho foljen ec. **Ai** filloi: Unë ec,... (Ai –anaforë)

Elipsa: - Ma (0) zgjedho foljen ec. (0) = ti

Kohezioni leksikor :

Përsëritje:

Unë **ec**, ti **ec**, ai **eci**. Unë**vrapoj** ti **vrapon**, ai **vrapon**.

Mësuesja i thotë **nxënësit**: - Ma zgjedho foljen ec. Ai filloi: Unë ec, ti ec, ai ec. Me shpejt, me shpejt - i tha **mësuesja**. Unë vrapoj ti vrapon, ai vrapon- ia pritë **nxënësi**.

9. BARSOLETA ME POLIC

Një polic e ndal një shofer dhe ia kërkon dokumentet. Ai ia kthen se nuk i ka. -Si mor nuk i ke, - asgjë a, shihe ndoshta i ke nëfioke, thotë polici, por shoferi përsëri ia kthen se s`ka asgjë përpos një pasqyre.

-Mirë ma jep pasqyrën i thotë polici.

E merr dhe shikon ne te dhe e sheh veten ne uniforme, dhe i thotë shoferit: Mire bre burrë pse s`po tregon qe edhe ti je polic?!!!

Kohezioni gramatikor:Referencë

Një polic e ndal një **shofer** dhe ia kërkon dokumentet. **Ai** ia kthen se nuk i ka.

Elipsa:

Si mor nuk i ke (0), - asgjë a, shihe ndoshta i ke (0) në fioke, thotë polici. (0) = ti.

Lidhshmëria: E merr shikon ne te **dhe** e sheh veten ne uniforme, **dhe** i thotë shoferit:

Kohezioni leksikor: Përsëritje

Një **polic** e ndal një **shofer** dhe ia kërkon dokumentet. Ai ia kthen se nuk i ka. -Si mor nuk i ke, - asgjë a, shihe ndoshta i ke në fioke, thotë **polic**, por **shoferi** përsëri ia kthen se s`ka asgjë...

- Shoferi përsëri ia kthen se s`ka asgjë përpos një **pasqyre**. -Mirë ma jep **pasqyrën** i thotë polici.

Hiponim:

-Mirë ma jep pasqyrën i thotë **polic**. E merr dhe shikon ne te dhe e sheh veten **ne uniforme**,

Kolokim:

Një **polic** e ndal një **shofer** dhe ia kërkon **dokumentet**

10. MENDIMI I NJËJTË

"Një mbrëmje vonë një grua bashkë me të bijën e vogël presin te shqetësuar burrin dhe babin, i cili nuk ishte kthyer ende ne shtëpi. Vajza e vogël i thotë se ëmës: "Mami, po sikur babi te ketë shkuar me ndonjë grua tjetër?" E ëma i përgjigjet: "Pse te shkon mendja për keq moj shpirt i mamit! Atë mund ta ketë shtypur ndonjë makine..."

I. Kohezioni gramatikor: Referencë

"Mami, po sikur **babi** te ketë shkuar me ndonjë grua tjetër?" E ëma i përgjigjet: "Pse te shkon mendja për keq moj shpirt i mamit! **Atë** mund ta ketë shtypur ndonjë makine". **atë** (ref.deftore)

II. Kohezioni leksikor: Përsëritje

"Një mbrëmje vonë një grua bashkë me të bijën e vogël presin te shqetësuara burrin dhe babin. shkuar me ndonjë grua tjetër.

Vajza e vogël i thotë se ëmës: "Mami, po sikur babi te ketë shkuar me ndonjë grua tjetër?"

E ëma i përgjigjet: "Pse te shkon mendja për keq moj shpirt i mamit!"

Sinonim:

Vajza e vogël i thotë se ëmës: "Mami, po sikur babi te ketë shkuar me ndonjë grua tjetër

"Një mbrëmje vonë një grua bashkë me të bijën e vogël presin te shqetësuara burrin dhe babin, i cili nuk ishte kthyer ende ne shtëpi. Vajza e vogël i thotë se ëmës

11. RAMAZANI

Ishte një plak dhe një djalë i ri.

- A po e agjëron ramazanin? - e pyet djali plakun.

- Po more krejt, i thotë plaku.

- Ta boftë zoti kabul, i thotë ky i riu.

- Ty ta befte Afganistan - ja kthen plaku.

I. Kohezioni gramatikor: Referenca

- A po e agjëron ramazanin? - e pyet djali plakun.- Po more krejt, i thotë plaku.

- Ta boftë zoti kabul, i thotë ky i riu. (ref. dëftore)

II . Kohezion leksikor: Përsëritje

Ishte një plak dhe një djalë i ri.- A po e agjëron ramazanin? - e pyet djali plakun.

Antonim

Ishte një plak dhe një djalë i ri

12. MARTESA

E pyet profesori studentin:

-Si quhet martesë me shumë gra?.

Ai përgjigjet, se kjo quhet poligami.

-Po ajo me një grua? – vazhdoi profesori.

Studenti ra në siklet, se nuk i kujtohej, ndërsa profesori deshi ta ndihmonte, duke i pëshpëritur fjalët mo..., mo ..., atëherë studentin u përgjigj duke thënë se martesë me një grua quhet monotoni.

I. Kohezioni gramatikor:

Referenca:

E pyet profesori studentin: -Si quhet martesë me shumë gra?. Ai përgjigjet, se ajo quhet poligami. (Ai- anaforë)

-Si quhet martesë me shumë gra? Studenti përgjigjet, se ajo quhet poligami.

II. Kohezioni leksikor


Përsëritje:

E pyet profesori studentin: Studenti ra në siklet, se nuk i kujtohej, ndërsa profesori deshi ta ndihmonte.


Si quhet martesë me shumë grua?. Ai përgjigjet, se kjo quhet poligami. -Po ajo me një grua? – vazhdoi profesori.

Kohezioni në Barsoleta


■ Kohezioni gramatikor ■ Kohezioni leksikor




Kohezioni gramatikor



Kohezioni leksikor



GJITHSEJ KOHEZIONI NË BARSOLETA



Përfundim

Pas një vështrimi, bërë me qëllim të gjetjes së Kohezionit në 12 barsoletat e marra si shembull, del se si të gjithë përbërësit e sistemit semantik, në këtë kategori, kohezioni realizohet me anë të sistemit leksiko-gramatikor. Në analizën e bërë këtyre barsoletave del më i shpeshtë kohezioni leksikor se ai gramatikor. Nga 77 shembujt e gjetur të kohezionit, 39 janë nga ai leksikor, ndërsa 38 i takojnë kohezionit gramatikor. Në përgjithësi më së shpeshti është përdorur Përsëritja.

Nga numri i përgjithshëm i kohezionit gramatikor të gjetur në këtë punim, del se më së shpeshti apo 16 herë është shfaqur referenca, në dy raste zëvendësimi, në tetë sosh elipsa, ndërsa lidhshmëria është shfaqur 12 herë. Kohezioni leksikor ka këtë paraqitje në barsoletat e analizuara. Më së shpeshti apo 22 herë është shfaqur përsëritja, katër herë antonimet, në dy raste kemi hiponime, metonomi kemi hasur vetëm në një shembull, ndërsa në gjashtë raste ka kolokim.

Referencat

Rugova, Bardh, *Gjuha e gazetave*, KOHA, Prishtinë, 2009

Rugova, Bardh, *Gjuha e filmit*, KOHA, Prishtinë, 2020

Rugova, Bardh, Sejdiu – Rugova, Linditë. *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*. Prishtinë: Trembelat, 2015.